

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna Shtime**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **2026/617-26-1132-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **“Mirëmbajtja e Infrastrukturës në Komunën e Shtimes (Kontratë kornizë, 36 muaj)”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“L'ART COMAG” SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga “Agim Ramadani”
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10 000
(Kodi postar)

+38349678122
(Numri Telefonit)

n/a
(Numri i Faks-it)

Arber Veselaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

l.artgroup8@gmail.com
(Adresa elektronike)

19.05.2026
(Data e parashtrimt të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim për Kontratë 11.03.2026
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave 19.05.2026.
B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 24.03.2026
Template per Dosja e Tenderit e korigjuar pas vendimit të OSHPsë.Docx 14.05.2026
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 14.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo n/a

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po n/a

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po x

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 44 i LPP-së
Neni 46 i LPP-së
Neni 17.17. i RrPP-së
Neni 62.2 i RrPP-së
Neni 48 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Një historik i shkurtër lidhur me këtë aktivitet të prokurimit:

AK më 10.09.2025 e ka ri tenderuar këtë aktivitet të prokurimit (Mirëmbajtja e infrastrukturës në Komunën e Shtimes, me numër të prokurimit: 617-25-8223-2-1-1), ndërsa kërkesat e dosjes së tenderit i ka përshtatur 100% për kompaninë Dashnim Jashari B.I., madje ky operator edhe është rekomanduar për kontratë, ndërsa Organi Shqyrtues i Prokurimit më 12.01.2026, nëpërmjet Vendimit **OSHP: 2025/1148, e ka ANULUAR NË TËRËSI** aktivitetin e prokurimit për faktin se OE “Dashnim Jashari” B.I. me emër tregtar N.T.P. “Ardhmëria” e ka hartuar vetë paramasën për këtë aktivitet të prokurimit. (Gjithashtu edhe për këto informata janë informuar organet e ndjekjes penale).

Tani AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin: “Mirëmbajtja e Infrastrukturës në Komunën e Shtimes (Kontratë kornizë, 36 muaj)”, me numër të prokurimit 2026/617-26-1132-2-1-1, ku në Dosjen e Tenderit ka paraqitur kërkesa tepër të larta, jo proporcionale dhe diskriminuuese, dhe madje shumë më të larta se tenderet paraprak lidhur me të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe për bindjen tonë përsëri ky tender është duke u përgatit për OE “Dashnim Jashari” B.I. ose ndonjë kompani tjetër të “kamuflluar”, mbrapa kësaj kompanie.

Këto kërkesa të vendosura në Dosje të Tenderit padyshim që i ka vetëm një OE, dhe se secili OE tjetër që aplikon do të shpallet i papërgjegjshëm, shtu këtu faktin që AK kundërligjshëm i ka shkurtuar edhe afatet për pranimin e ofertave.

Ju rikujtojmë se kjo qasje e AK-së është e kundërligjshme dhe është keqpërdorim i hapur i parasë publike dhe ne si kompani do të trokasim në çdo derë institucionale për të kërkuar ligjshmëri dhe për të mbrojtur të drejtat tona si operator ekonomik.

Pretendimet lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja e Infrastrukturës në Komunën e Shtimes (Kontratë kornizë, 36 muaj)”, me numër të prokurimit 2026/617-26-1132-2-1-1

Komuna e Shtimes, më 11.03.2026, ka publikuar Njoftimin për Kontratë për Aktivitetin e Prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e Infrastrukturës në Komunën e Shtimes (Kontratë kornizë, 36 muaj)”, me numër të prokurimit 2026/617-26-1132-2-1-1 dhe vlerë të parashikuar 350,000.00 euro.

Ne si OE me interes për aplikim në këtë aktivitet të prokurimit, pas analizimit të Dosjes së Tenderit dhe kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit, vlerësojmë se një numër i konsiderueshëm i kërkesave të vendosura në listën e makinerisë janë **jo proporcionale, diskriminuese, të paarsyetuara dhe nuk lidhen drejtpërdrejt me natyrën e punëve të parapara në paramasë**, duke krijuar kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit.

Sipas **nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të sigurojë trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe konkurrencë efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Ne si OE të pakënaqur me këtë vendim të paarsyetuar dhe të kundërligjshëm, brenda afateve ligjore e paraqesim këtë Ankesë dhe atë mbi këto pretendime ankimore:

Kërkesa sipas listës së Aneks 7, për disa nga makineritë është pajustificueshme dhe në kundërshtim me LPP-në.

Operatori ekonomik “*L’ART COM AG*” SH.P.K., konsideron se kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktues për një numër të konsiderueshëm pajisjesh dhe makinerish janë të pajustificuara teknikisht, jo proporcionale dhe jo të lidhura me natyrën e punëve të parapara në paramasën e këtij aktiviteti të prokurimit. Për më tepër, një pjesë e këtyre kërkesave nuk kanë qenë të përfshira në dosjen e tenderit të procedurës paraprake për të njëjtin aktivitet të prokurimit, ndonëse bëhet fjalë faktikisht për ritenderim të të njëjtit aktivitet, ndërsa paramasa e punëve dhe natyra e projektit kanë mbetur të pandryshuara.

Vendosja e kërkesave të reja dhe më restriktive në një procedurë të ritenderuar, pa ndonjë ndryshim real në objektin e kontratës, krijon dyshim të arsyeshëm për kufizim artificial të konkurrencës dhe bie ndesh me parimet e konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në prokurim publik.

Pretendimet tona lidhur me kërkesat për makineritë të cilat i konsiderojmë jo proporcionale dhe diskriminuese po i rendisim në vazhdim:

Pretendimi 3: Kamion kiper me kran dhe korpë me kapacitet min. 10 m3, krani me hapje min. 20m të dëshmohet me a test.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për posedimin e një kamioni kiper me kran dhe korpë kapacitet min. 10 m3, krani me hapje minimale 20 metra si dhe të dëshmohet me a test, është e pajustificuar dhe joproporcionale në raport me objektin e kontratës dhe punët e parapara në paramasën e punëve.

Nga analiza e paramasës së punëve rezulton qartë se aktivitetet e parapara në këtë kontratë përfshijnë kryesisht transport dhe bartje të materialeve ndërtimore, aktivitete këto të cilat zakonisht realizohen me kamionë kiper standardë, pa pasur nevojë për përdorimin e një krani me hapje 20 metra. Në asnjë pozicion të paramasës së punëve nuk është paraparë ndonjë aktivitet teknik që kërkon ngritje apo manipulim të materialeve në lartësi të tilla që do ta bënte të domosdoshëm përdorimin e një krani me këto specifika.

Për rrjedhojë, kërkesa për një makineri të tillë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e kontratës, por përkundrazi paraqet një kriter artificial që kufizon konkurrencën në procedurë. Në praktikën e prokurimit publik, kërkesat për pajisje dhe mekanizëm duhet të jenë drejtpërdrejt të lidhura dhe proporcionale me natyrën e punëve që do të realizohen, përndryshe konsiderohen si barriera të pajustificuara për pjesëmarrje. Pastaj dëshmimi me a test nuk mund të nënkuptohet tjetër, pos një barrierë shtesë për operatorët ekonomik, pa e justifikuar se pse në këtë rast nevojitet të dëshmohet me a test.

Vendosja e një kriteri të tillë bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, konkretisht me parimin e trajtim të barabartë dhe mosdiskriminimit, si dhe me parimin e proporcionalitetit, pasi kërkesa për një kran me hapje minimale 20 metra kufizon në mënyrë të panevojshme operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje të mjaftueshme për realizimin e kontratës, por që nuk kanë këtë lloj makinerie specifike.

Po ashtu, një kriter i tillë krijon dyshime serioze se është vendosur në mënyrë të qëllimshme për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, i cili posedon këtë lloj pajisjeje, duke reduktuar në mënyrë artificiale konkurrencën në këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me praktikën e mira të prokurimit dhe legjislacionin në fuqi, Autoriteti Kontraktues ka obligim që kriteret e kualifikimit t'i vendosë në mënyrë proporcionale, objektive dhe të arsyeshme, duke siguruar që ato të jenë të nevojshme për realizimin e kontratës dhe të mos krijojnë barriera të panevojshme për pjesëmarrje.

Duke qenë se në paramasën e punëve nuk ekziston asnjë aktivitet që kërkon përdorimin e një krani me hapje 20 metra, kërkesa e tillë konsiderohet e panevojshme dhe diskriminuese. Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta largojë ose modifikojë këtë kriter, në mënyrë që të jetë në përputhje me natyrën reale të punëve dhe të mundësojë konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 4: Gjysmë-rimorkio me lift për prerjen e drunjve me lartësi min. 25 m (lartësia të dëshmohet me atest ose pëlqim)

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për posedimin e gjysmë-rimorkios me lift për prerjen e drunjve me lartësi minimale 25 metra (lartësia të dëshmohet me atest ose pëlqim) është e pajustificuar dhe joproporcionale në raport me natyrën dhe përmbajtjen e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga shqyrtimi i paramasës së punëve rezulton se në kuadër të këtij projekti nuk janë paraparë aktivitete specifike që përfshijnë prerje apo trajtim të drunjve në lartësi të tilla, e aq më pak aktivitete që do ta bënin të domosdoshëm përdorimin e një pajisjeje të specializuar siç është gjysmë-rimorkio me lift me kapacitet ngritjeje deri në 25 metra. Në mungesë të një aktiviteti të tillë të specifikuar në paramasë, kërkesa për këtë lloj mekanizmi rezulton të jetë e shkëputur nga objekti real i kontratës.

Në procedurat e prokurimit publik, Autoriteti Kontraktues ka obligim që kërkesat për pajisje dhe mekanizëm t'i përcaktojë në mënyrë të tillë që ato të jenë drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme për realizimin e kontratës, si dhe të jenë proporcionale me kompleksitetin dhe natyrën e punëve që do të kryhen. Vendosja e kërkesave për pajisje të specializuara, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet konkrete të parashikuara në paramasë, përbën vendosje të kriterëve artificiale të kualifikimit, të cilat krijojnë barriera të panevojshme për pjesëmarrje në procedurë.

Për më tepër, pajisje të tilla janë mekanizma shumë specifike dhe jo të zakonshëm për operatorët ekonomikë që merren me realizimin e punëve të natyrës së kësaj kontrate, gjë që në praktikë redukton ndjeshëm numrin e operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në tender. Si rezultat, një kërkesë e tillë ka efekt të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës dhe në trajtimin e pabarabartë të operatorëve ekonomikë.

Vendosja e një kriteri të tillë bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht parimin e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, pasi kërkon një pajisje të specializuar që nuk është e nevojshme për realizimin e kontratës dhe që nuk arsyetohet nga përmbajtja e paramasës së punëve.

Për më tepër, kur kërkesat teknike vendosen në mënyrë të tillë që vetëm një numër shumë i kufizuar operatorësh ekonomikë mund t'i përmbushin ato, krijohet një perceptim i bazuar se kriteri është përcaktuar në mënyrë të qëllimshme për të favorizuar një operator të caktuar, duke reduktuar konkurrencën reale në procedurë dhe duke cenuar transparencën e procesit të prokurimit.

Duke qenë se paramasa e punëve nuk përfshin aktivitete të prerjes së drunjve në lartësi që do ta bënin të domosdoshëm përdorimin e një gjysmë-rimorkioje me lift 25 metra, kërkesa e tillë konsiderohet e pajustificuar dhe diskriminuese. Për këtë arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta largojë ose ta modifikojë këtë kriter, në mënyrë që kërkesat për mekanizëm të jenë në përputhje me natyrën reale të punëve dhe të mundësohet konkurrencë e drejtë ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 5: Traktor 4x4 max 1.5 ton me kositëse dhe rezervuar për mbledhje të barit

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për **traktor me tonazh maksimal deri në 1.5 ton** për realizimin e punëve të kositjes së barit paraqet një kriter teknik të pajustificuar kufizues dhe diskriminues në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga analiza e paramasës së punëve rezulton se aktivitetet kryesore përfshijnë **kositjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve me bar**, të cilat zakonisht realizohen me mekanizma të ndryshëm bujqësorë apo komunalë, përfshirë traktorë dhe pajisje të tjera për kositje, pa qenë e domosdoshme vendosja e një kufizimi strikt në tonazhin maksimal të mjetit.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar ndonjë **arsyetim teknik apo operativ** se përse realizimi i këtyre punëve do të ishte i mundur vetëm me traktorë me tonazh maksimal 1.5 ton dhe pse përdorimi i traktorëve me kapacitete të tjera do ta pamundësonte ose do ta vështirësonte realizimin e kontratës. Në mungesë të një arsytimi të tillë, kufizimi i tonazhit rezulton të jetë një **specifikim teknik arbitrar**, i cili nuk lidhet drejtpërdrejt me cilësinë apo efektivitetin e realizimit të punëve të kontraktuara.

Në praktikën e prokurimit publik, Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktojë kërkesat teknike në mënyrë që ato të jenë **të nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës**, si dhe të mos krijojnë kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë. Vendosja e një kufizimi të tillë në tonazhin e mekanizmit nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatin që kërkohet nga kontrata, që është kositja dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve me bar. Pasi kjo punë mund të realizohet në mënyrë efektive edhe me traktorë me kapacitete të tjera, përderisa ata janë të pajisur me mekanizmat e nevojshëm për kositje.

Për më tepër, një specifikim i tillë teknik ka efekt të drejtpërdrejtë në **kufizimin e konkurrencës**, pasi përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë mekanizëm të përshtatshëm për realizimin e punëve, por që nuk përputhet me kufizimin artificial të tonazhit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë mënyrë, krijohen barriera të panevojshme për pjesëmarrje dhe reduktohet numri i operatorëve ekonomikë që mund të konkurrojnë në këtë procedurë.

Vendosja e kriterëve të tilla bie ndesh me **parimet themelore të prokurimit publik**, veçanërisht me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Kur një kërkesë teknike nuk është e lidhur me nevojat reale të kontratës dhe kufizon në mënyrë të panevojshme pjesëmarrjen në tender, ajo konsiderohet një kriter diskriminues dhe i papranueshëm në kuptim të legjislacionit të prokurimit publik.

Duke qenë se **paramasa e punëve parashikon vetëm kositjen e barit dhe nuk ekziston ndonjë arsye teknike që justifikon kufizimin e tonazhit maksimal të traktorëve në 1.5 ton**, kërkesa e tillë konsiderohet e pajustificuar dhe kufizuese për konkurrencën. Për këtë arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta **largojë këtë kufizim ose ta modifikojë kriterin**, duke lejuar përdorimin e mekanizmave të përshtatshëm për realizimin e punëve pa vendosur kufizime të panevojshme teknike.

Pretendimi 6: Traktor max 1 ton i pajisur me fshesë me atest

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për traktor maksimal 1 ton të pajisur me fshesë paraqet një kriter teknik diskriminues në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga përmbajtja e paramasës së punëve rezulton se aktivitetet përfshijnë kryesisht pastrim dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve, punë të cilat mund të realizohen me mekanizma të ndryshëm të pajisur me fshesë mekanike, pa qenë e nevojshme vendosja e një kufizimi strikt në peshën apo tonazhin maksimal të traktorit. Në këtë rast, elementi funksional është pajisja me fshesë, ndërsa kufizimi i tonazhit në maksimum 1 ton nuk ndikon në cilësinë apo efikasitetin e realizimit të punëve.

Vendosja e një kufizimi të tillë teknik nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e kontratës dhe për rrjedhojë përbën një kriter artificial që kufizon konkurrencën, pasi përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë mekanizma të përshtatshëm për kryerjen e punëve, por me kapacitete të ndryshme nga ato të specifikuara. Kërkesat për pajisje duhet

të jenë proporcionale dhe të arsyetuara teknikisht, ndërsa kufizime të tilla specifike, pa ndonjë justifikim në paramasën e punëve, krijojnë pengesa të panevojshme për pjesëmarrje dhe cenonjë parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Pastaj kërkesa që kjo pajisje të dëshmohet me atest paraqet një kërkesë shtesë të panevojshme dhe jo të zakonshme në praktikën e procedurave të prokurimit për këtë lloj mekanizmi. Në dokumentacion nuk jepet asnjë sqarim mbi llojin e atestit që kërkohet apo bazën ligjore mbi të cilën kërkohet një dëshmi e tillë. Në procedurat e prokurimit zakonisht kërkohet vetëm dëshmia e posedimit apo disponueshmërisë së mekanizmit, ndërsa kërkesa për një atest të paqartë nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Duke qenë se paramasa e punëve nuk ofron asnjë arsyetim teknik për kufizimin e traktorit në maksimum 1 ton dhe me atest, kërkesa e tillë konsiderohet e panevojshme dhe kufizuese për konkurrencën. Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta modifikojë këtë kriter, duke lejuar përdorimin e mekanizmave të përshtatshëm për pastrim të pajisur me fshesë, pa vendosur kufizime të panevojshme në tonazhin e tyre.

Pretendimi 7: Eskavator i pajisur me qekan dhe gërshërë max 500 kg

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për “eskavator të pajisur me qekan dhe gërshërë max 500 kg” paraqet një specifikim teknik të panevojshëm dhe kufizues në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga shqyrtimi i paramasës së punëve nuk rezulton ndonjë aktivitet specifik që do ta bënte të domosdoshëm kufizimin e mekanizmit në një peshë maksimale prej 500 kg. Punët e gërmimit apo demolimit mund të realizohen me një gamë të gjerë eskavatorësh dhe pajisjesh përcjellëse, të cilët mund të pajisen me qekan apo gërshërë hidraulike, pa qenë e nevojshme vendosja e një kufiri kaq të ngushtë në peshë.

Vendosja e kufirit maksimal prej 500 kg nuk lidhet drejtpërdrejt me rezultatin që kërkohet nga kontrata, por përkundrazi përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë mekanizma plotësisht funksionalë dhe të përshtatshëm për realizimin e punëve, por që tejkalojnë këtë kufizim artificial në peshë. Në praktikë, përdorimi i pajisjeve me kapacitete të ndryshme shpesh është më efikas dhe më i përshtatshëm varësisht nga kushtet në terren, andaj një kufizim i tillë nuk ka arsyetim teknik të qëndrueshëm.

Në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, kërkesat teknike duhet të jenë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke mos krijuar barriera të panevojshme për konkurrencën. Kufizimi i peshës në këtë rast përbën një specifikim të tepërt, i cili cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe të mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

Duke qenë se paramasa e punëve nuk ofron arsyetim teknik për këtë kufizim specifik, kërkohet nga Autoriteti Kontraktues që të largojë kufirin “max 500 kg” dhe të lejojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë pajisje funksionalisht të përshtatshme për realizimin e kontratës.

Pretendimi 8: Cilinder për ngjeshje max 1 ton

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për cilindër për ngjeshje me kapacitet maksimal 1 ton paraqet një specifikim teknik të pajustificuar dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga analiza e paramasës së punëve nuk rezulton ndonjë aktivitet konkret që do ta bënte të domosdoshëm kufizimin e kapacitetit të cilindrit pikërisht në maksimum 1 ton. Në praktikën e realizimit të punimeve të ngjeshjes, makineritë me kapacitete më të mëdha mund të kryejnë të njëjtin funksion në mënyrë efektive dhe pa ndikuar negativisht në realizimin e kontratës apo në cilësinë e punimeve.

Vendosja e një kufizimi të tillë në kapacitetin e makinerisë, pa ndonjë arsytim teknik të qartë në paramasën e punëve, krijon një kufizim artificial të konkurrencës, pasi përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve, por me kapacitete të ndryshme nga ato të specifikuara. Kërkesat për mekanizëm duhet të jenë të arsyetuara dhe proporcionale me nevojat reale të kontratës, ndërsa specifikimet tepër të ngushta teknike krijojnë barriera të panevojshme për pjesëmarrje.

Duke qenë se paramasa e punëve nuk ofron ndonjë arsytim teknik për kufizimin e kapacitetit të cilindrit në maksimum 1 ton, ky kriter konsiderohet i panevojshëm dhe kufizues për konkurrencën. Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta modifikojë këtë kërkesë, duke lejuar përdorimin e pajisjeve të përshtatshme për ngjeshje pa vendosur kufizime të panevojshme në kapacitetin e tyre.

Pretendimi 9: Cilinder me dhëmbëza i pajisur me lugë për nivelizim të materialeve 3-4 ton

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për cilindër me dhëmbëza të pajisur me lugë për nivelizim të materialeve me kapacitet 3–4 ton paraqet një specifikim teknik të pajustificuar dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga shqyrtimi i paramasës së punëve nuk rezulton ndonjë aktivitet specifik që do ta bënte të domosdoshëm përdorimin e një pajisjeje kaq të veçantë dhe të specializuar, siç është cilindri me dhëmbëza i pajisur me lugë për nivelizim. Punët e nivelizimit dhe përgatitjes së sipërfaqeve zakonisht realizohen edhe me makineri të tjera standarde ndërtimore, të cilat janë gjerësisht të përdorura në praktikë dhe mund të kryejnë të njëjtin funksion pa qenë e nevojshme specifikimi i një mekanizmi kaq të veçantë.

Për më tepër, vendosja e një tonazhe të caktuar kapaciteti 3–4 ton, pa ndonjë arsytim teknik në paramasën e punëve, përbën një kufizim të panevojshëm që redukton numrin e operatorëve ekonomikë që mund të përmbushin këtë kriter. Duke qenë se ky lloj mekanizmi është relativisht i rrallë dhe jo i zakonshëm në përdorim për punë të tilla, kërkesa krijon një barrierë artificiale për pjesëmarrje dhe kufizon konkurrencën në procedurë.

Në mungesë të një arsytimi të qartë teknik që lidhet drejtpërdrejt me paramasën e punëve, një kërkesë e tillë konsiderohet e panevojshme dhe potencialisht diskriminuese, pasi përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë makineri të tjera funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve. Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta largojë këtë kriter, në mënyrë që kërkesat për mekanizëm të jenë proporcionale me nevojat reale të kontratës dhe të mos kufizojnë pa arsye konkurrencën.

Pretendimi 10: Gjysmë-rimorkio për kositjen dhe blurjen e barit me vetgrumbullim

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për gjysmë-rimorkio për kositjen dhe bluarjen e barit me vetgrumbullim paraqet një specifikim teknik të pajustificuar dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në procedurën paraprake të këtij aktiviteti të prokurimit një pajisje e tillë nuk ishte kërkuar, ndërkohë që natyra dhe përmbajtja e punëve që do të realizohen kanë mbetur të njëjta. Në mungesë të ndonjë ndryshimi në paramasën e punëve apo në kërkesat teknike të projektit, shtimi i një kriteri të ri për një pajisje kaq specifike nuk duket të jetë i bazuar në ndonjë analizë reale teknike apo operacionale.

Punët e kositjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve me bar zakonisht realizohen me mekanizma të ndryshëm për kositje dhe grumbullim, të cilët janë gjerësisht të përdorur në praktikë. Specifikimi i një pajisjeje të veçantë me funksion vetgrumbullimi kufizon në mënyrë të panevojshme operatorët ekonomikë që posedojnë mekanizma të tjerë funksionalisht të përshtatshëm për realizimin e të njëjtave punë.

Në këto rrethana, vendosja e këtij kriteri krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje dhe kufizon konkurrencën, pasi përjashton operatorët ekonomikë që mund të realizojnë kontratën me pajisje të tjera adekuate. Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë respektivisht largoj këtë kërkesë, duke përcaktuar kriteret teknike që janë proporcionale me natyrën reale të punëve dhe që nuk kufizojnë pa arsye konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 11: Makinë hidraulike për prerjen e drunjve, barishtave dhe shkurreve me gjerësi 1 m

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për makineri hidraulike për prerjen e drunjve, barishtave dhe shkurreve me gjerësi 1 metër paraqet një specifikim teknik të panevojshëm dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga shqyrtimi i paramasës së punëve nuk rezulton ndonjë aktivitet konkret që do ta bënte të domosdoshëm përdorimin e pikërisht kësaj pajisjeje të specializuar, e aq më pak vendosjen e një kufizimi specifik të gjerësisë në 1 metër. Punët që lidhen me prerjen e barishtave, shkurreve apo mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra zakonisht realizohen me pajisje të ndryshme të përshtatshme për këtë qëllim, të cilat mund të kenë dimensione dhe karakteristika teknike të ndryshme, pa ndikuar në realizimin e kontratës.

Vendosja e një specifikimi kaq të ngushtë teknik, pa ndonjë arsyetim të qartë në paramasën e punëve, krijon një kufizim artificial të konkurrencës, pasi përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve, por me dimensione apo karakteristika të ndryshme nga ato të kërkuara. Në mungesë të një justifikimi teknik për këtë kufizim, kërkesa rezulton të jetë e panevojshme dhe potencialisht diskriminuese.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta largoj këtë kriter, duke përcaktuar kërkesa teknike që janë proporcionale me natyrën reale të punëve dhe që nuk vendosin kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë.

Pretendimi 12: Gjysmërimorkio speciale për deblokimin e kanalizimit dhe zbrazje të pusetave me dy pompa e cila funksionon me sistem traktori min.6000 kg me presion min 200 bar;

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për gjysmërimorkio speciale për debllokimin e kanalizimit dhe zbrazje të pusetave me dy pompa e cila funksionon me sistem traktori min.6000 kg me presion min 200 bar paraqet një ndryshim të pajustificuar teknikisht në raport me kërkesat e përcaktuara në procedurën paraprake të të njëjtit aktivitet të prokurimit.

Në dosjen e mëparshme të tenderit ishte kërkuar vetëm presioni i pompës prej 250 bar, pa ndonjë specifikim lidhur me sistemin e mekanizmit apo peshën minimale të tij. Në këtë ritenderim është shtuar një kërkesë e re për sistem traktori minimal 6000 kg, ndërsa në të njëjtën kohë është ulur edhe presioni minimal i pompës në 200 bar, pa ndonjë shpjegim teknik apo ndryshim në paramasën e punëve që do ta justifikonte këtë modifikim të kriterëve.

Vendosja e një kërkesë të tillë për peshën minimale të traktorit nuk lidhet drejtpërdrejt me performancën apo efektivitetin e procesit të debllokimit të kanalizimit, pasi funksionaliteti i kësaj pajisjeje përcaktohet kryesisht nga kapaciteti dhe presioni i sistemit të pompës, e jo nga pesha e mjetit që e transporton atë. Për rrjedhojë, kufizimi në peshë paraqet një specifikim teknik të panevojshëm, i cili përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve, por që nuk përputhen me këtë kërkesë specifike.

Në këto rrethana, ndryshimi i kriterëve teknike pa ndonjë arsyetim të qartë dhe pa ndonjë ndryshim në natyrën e punëve krijon dyshim të bazuar ppr përshtatje të specifikave vetëm për një operator, duke refuzuar kështu konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë dhe modifikojë këtë kriter, në mënyrë që kërkesat teknike të jenë proporcionale me objektin e kontratës dhe të mos krijojnë kufizime të panevojshme për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Pretendimi 13: Kamion -Autoboot për transport të ujit, të dëshmohet me atest.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për kamion – autoboot për transport të ujit, si dhe kërkesa që kjo të dëshmohet me atest, paraqet një specifikim teknik të pajustificuar dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Së pari, kufizimi i kapacitetit minimal në 12,000 litra nuk është i arsyetuar teknikisht në dokumentacionin e tenderit dhe nuk lidhet me ndonjë kërkesë konkrete të paramasës së punëve. Në praktikë, transporti dhe furnizimi me ujë mund të realizohet edhe me autobote me kapacitete të ndryshme, përderisa ato janë funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve. Vendosja e **atest** , pa ndonjë arsyetim teknik apo operativ, përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë mjete me kapacitete të tjera të përshtatshme dhe për rrjedhojë krijojnë një kufizim artificial të konkurrencës.

Së dyti, kërkesa që ky mjet të dëshmohet me atest paraqet një kërkesë shtesë të panevojshme dhe të pazakontë në praktikën e procedurave të prokurimit për pajisje të tilla. Dokumentacioni standard i prokurimit zakonisht kërkon dëshmi mbi posedimin apo disponueshmërinë e mekanizmit (si p.sh. librezë qarkullimi, kontratë qiraje apo dëshmi tjetër e vlefshme), ndërsa kërkesa për atest specifik për një autobotë për transport uji nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës. Për më tepër, në dokumentacion nuk jepet asnjë sqarim se për çfarë lloj atesti bëhet fjalë dhe mbi cilën bazë ligjore apo teknike kërkohet një dëshmi e tillë.

Në këto rrethana, kombinimi i një kapaciteti minimal të përcaktuar në mënyrë arbitrare dhe kërkesa për dëshmim me atest, pa ndonjë arsyetim teknik në dokumentacionin e tenderit,

krijon një barrierë të panevojshme për pjesëmarrje dhe kufizon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë dhe modifikojë këtë kriter, duke hequr kufizimin e panevojshëm të kapacitetit minimal dhe kërkesën për atest, në mënyrë që kriteret për mekanizëm të jenë proporcionale me natyrën e punëve dhe të mos kufizojnë pa arsye pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit.

Pretendimi 14: Kamion për pastrimin e kanalizimeve me thithje dhe vakum me atest

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për kamion për pastrimin e kanalizimeve me sistem thithjeje dhe vakumi si dhe kërkesa që kjo pajisje të dëshmohet me atest, paraqet një specifikim teknik të pajustificuar dhe joproporcional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Kërkesa që kjo pajisje të dëshmohet me atest paraqet një kërkesë shtesë të panevojshme dhe jo të zakonshme në praktikën e procedurave të prokurimit për këtë lloj mekanizmi. Në dokumentacion nuk jepet asnjë sqarim mbi llojin e atestit që kërkohet apo bazën ligjore mbi të cilën kërkohet një dëshmi e tillë. Në procedurat e prokurimit zakonisht kërkohet vetëm dëshmia e posedimit apo disponueshmërisë së mekanizmit, ndërsa kërkesa për një atest të paqartë nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Kërkesa për dëshmim me atest, pa ndonjë sqarim në dokumentacionin e tenderit, krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje dhe kufizon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë dhe modifikojë këtë kriter, duke hequr kërkesën për atest, në mënyrë që kërkesat për mekanizëm të jenë proporcionale me natyrën reale të punëve dhe të mos kufizojnë pa arsye konkurrencën në këtë procedurë të prokurimit.

Pretendimi 15: Furgon i pajisur me sistem për pastrim dhe larje të kanalizimeve, me atest

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për furgon të pajisur me sistem për pastrim dhe larje të kanalizimeve, i cili duhet të dëshmohet me atest, paraqet një sp

ecifikim teknik të paqartë dhe të pajustificuar në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Së pari, në dokumentacionin e tenderit nuk jepet ndonjë përshkrim i qartë teknik mbi karakteristikat apo kapacitetin e sistemit të kërkuar për pastrim dhe larje të kanalizimeve, gjë që e bën këtë kriter të paqartë dhe të vështirë për t'u interpretuar në mënyrë të njëjtë nga të gjithë operatorët ekonomikë. Një formulim i tillë krijon hapësirë për interpretime të ndryshme gjatë fazës së vlerësimit dhe për rrjedhojë mund të ndikojë negativisht në transparencën dhe barazinë e trajtimit të operatorëve ekonomikë.

Së dyti, kërkesa që kjo pajisje të dëshmohet me atest nuk është e shoqëruar me ndonjë sqarim mbi llojin e atestit që kërkohet, institucionin që e lëshon apo bazën ligjore mbi të cilën kërkohet një dokument i tillë. Në praktikën e procedurave të prokurimit, zakonisht kërkohet vetëm dëshmia e posedimit apo disponueshmërisë së mekanizmit, ndërsa kërkesa

për një atest të paqartë krijon një ngarkesë të panevojshme administrative për operatorët ekonomikë dhe mund të shërbejë si kriter kufizues për pjesëmarrje.

Në mungesë të një arsytimi teknik dhe të një përkufizimi të qartë të kërkesës, një kriter i tillë rezulton në kufizim të panevojshëm të konkurrencës, pasi operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve mund të përjashtohen për shkak të një kërkesë të paqartë dhe të paargumentuar.

Përtej kësaj, kërkesa për këtë pajisje është e dyfishtë në raport me pajisjet e tjera për pastrim kanalizimesh, duke krijuar kërkesa të tepërta për të njëjtin funksion teknik.

Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta largoj këtë kërkesë diskriminuese.

Pretendimi 16: Lugë ngarkuese me pirun dhe fshesa min.5 ton (korigjimi)

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për lugë ngarkuese të pajisur me pirun dhe fshesë me kapacitet minimal prej 5 tonësh paraqet një specifikim teknik të panevojshëm dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Së pari, përcaktimi i një kapaciteti minimal prej 5 tonësh nuk është i arsyetuar në dokumentacionin e tenderit dhe nuk mbështetet në ndonjë kërkesë konkrete të paramasës së punëve që pritet të ekzekutohen. Punët e ngarkimit dhe pastrimit me fshesë mekanike mund të realizohen në mënyrë efektive edhe me makineri me kapacitet më të vogël, përderisa ato janë teknikisht të përshtatshme dhe të pajisura me mekanizmat përkatës.

Së dyti, funksionaliteti i pirunit dhe i fshesës mekanike nuk është i varur drejtpërdrejt nga kapaciteti minimal prej 5 tonësh. Pajisjet shpesh si piruni dhe fshesa mund të instalohen dhe të përdoren në kategori të ndryshme të lugëve ngarkuese, pa qenë e nevojshme të vendoset një prag i tillë minimal. Për rrjedhojë, kërkesa në fjalë nuk ndikon në mënyrë thelbësore në performancën e realizimit të punëve.

Së treti, vendosja e një kufiri minimal të kapacitetit krijon një kufizim të panevojshëm të konkurrencës, duke përjashtuar operatorët ekonomikë që posedojnë makineri funksionalisht të përshtatshme, por me kapacitet më të vogël, të cilat do të mund të realizonin punët në mënyrë të rregullt dhe efikase.

Për rrjedhojë, kërkesa për lugë ngarkuese me pirun dhe fshesë me kapacitet minimal 5 ton konsiderohet një specifikim teknik i panevojshëm dhe kufizues për konkurrencën. Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë këtë kriter dhe ta modifikojë atë, duke lejuar përdorimin e makinerive që janë funksionalisht të përshtatshme për realizimin e punëve, pa vendosur kufizime të panevojshme lidhur me kapacitetin e tyre.

Pretendimi 18: Makinë e punës (Dumper vetëshkarkues) në tre anet ,min 5 ton , me atest.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për makinë pune (dumper vetëshkarkues në tre anët) me kapacitet minimal 5 ton, si dhe kërkesa që kjo pajisje të dëshmohet me atest, paraqet një specifikim teknik të pajustificuar dhe joproportional në raport me natyrën e punëve të parapara në këtë aktivitet të prokurimit.

Së pari, kufizimi i kapacitetit minimal në 5 ton nuk është i arsyetuar në dokumentacionin e tenderit dhe nuk lidhet me ndonjë kërkesë konkrete të paramasës së punëve. Në praktikë,

transporti dhe shkarkimi i materialeve mund të realizohet edhe me makineri të tjera të përshtatshme me kapacitete të ndryshme, përderisa ato janë funksionalisht të afta për kryerjen e punëve të parapara. Vendosija e një kufiri minimal të tillë, pa ndonjë arsytim teknik apo operativ, përjashton operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje të ngjashme por me kapacitete të tjera të përshtatshme për realizimin e kontratës, duke krijuar kështu një kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

Së dyti, kërkesa që kjo pajisje të dëshmohet me atest paraqet një kërkesë shtesë të paqartë dhe jo të zakonshme në praktikën e procedurave të prokurimit për këtë lloj mekanizmi. Në dokumentacionin e tenderit nuk jepet ndonjë sqarim mbi llojin e atestit që kërkohet, institucionin që e lëshon apo bazën ligjore mbi të cilën kërkohet një dokument i tillë. Në procedurat e prokurimit zakonisht kërkohet vetëm dëshmia e posedimit apo disponueshmërisë së pajisjes, ndërsa kërkesa për një atest të paqartë nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin e kontratës.

Në këto rrethana, kombinimi i një kapaciteti minimal të përcaktuar pa arsytim teknik dhe kërkesa për dëshmim me atest, pa ndonjë sqarim në dokumentacionin e tenderit, krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje dhe kufizon konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye kërkohet që Autoriteti Kontraktues ta rishqyrtojë dhe modifikojë këtë kriter, duke hequr kufizimin e panevojshëm të kapacitetit minimal dhe kërkesën për atest, në mënyrë që kërkesat për mekanizëm të jenë proporcionale me natyrën reale të punëve dhe të mos kufizojnë pa arsye pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit.

Përfundimisht bazuar në atë që u tha më lartë AK nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, përkatësisht qëllimin, pastaj nenin 6, paragrafi 1, i cili saktëson se: *“Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”*.

Ndërsa neni 7, paragrafi 1, 2, dhe 6 i LPP-së, ekskluzivisht ndalon diskriminimin si dhe përshtatjen e kriterëve, respektivisht:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës

kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

AK nuk ka zbatuar nenin 44 të LPP-së, ashtu që ka shkurtuar afatet e pranimit të tenderëve nga 40 ditë sa është minimumi i lejuar me ligj, në vetëm 20 ditë, përkundër që nuk paraqet në mënyrë bindëse asnjë nga justifikimet e parapara në nenin 46 të LPP-së.

Gjithashtu AK nuk ka respektuar nenin 62.2 të RrPP-së, lidhur me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative kur ka refuzuar Kërkesën tonë për Rishqyrtim, pa dhënë asnjë arsyetim bindës dhe konkret, ashtu siç e obligo ligji.

Andaj duke u nisur nga ajo që u tha më lartë Organit Shqyrtues të Prokurimit i propozojmë që të marrë këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE “*L’ART COM AG*” SH.P.K
- II. ANULOHET** Njoftimi për Kontratë i datës 11.03.2026 dhe Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i datës 24.03.2026, ashtu që **DETYROHET** AK Komuna e Shtimes të përpiloj kërkesat sipas dispozitave të LPP-së dhe gjetjeve të Panelit Shqyrtues.
- III. OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues që ankuesit OE “*L’ART COM AG*” SH.P.K SH.P.K. t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në emër të përgatitjes së Kërkesës për Rishqyrtim dhe Ankesës.
- IV. KTHEHEN** mjetet e deponuara në emër të taksës për ankesë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

“L’ART COM AG” SH.P.K deri në këtë fazë të procedurës i janë shkaktuar dëme sa i përket hartimit të Kërkesës për Rishqyrtim, Ankesës për OSHP dhe përgatitje të dokumentacionit sipas Dosjes së Tenderit. Nëse AK nuk aprovon këtë Ankesë, dëmet që do na shkaktohen si kompani do të jenë jashtëzakonisht të mëdha, ndërsa ne do të kërkojmë kompensim dëmi pranë organeve administrative dhe gjyqësor nga Komuna e Shtimes si përgjegjëse direkte për shkaktimin e këtij dëmi.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.